

KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS

Nr. 08-756/2

16.02.2026

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 6-të e rregullt e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 16.02.2026 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10.

Seancën në ora 10 e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Ajhan Sulkoski, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Zhaneta Milanoska Petreska, Aleksandar Mickoski, Mihajlo Daniloski, Irena Naumoska, Violeta Stefanoska, Bojan Trajkoski, Dragan Dejanoski, Mirsad Ramazanoski, Ilir Rushani, Shefki Imeti, Siarta Saliju Osmani, Asip Zendeli, Fadil Emini, Teuta Ahmedo Purellku dhe Kujtim Kasami, Beqir Osmani dhe Stevo Stefanoski.

Në mungesë ishte këshilltarja Latife Imani.

Në seancë ishin të pranishëm edhe: Sekretarja e komunës – Aneta Nasteska, Valdet Selimi, Bujar Veseli, Riste Lazarovski, Igor Pejoshi, Emilija Petkoska, Lençe Srbinoska, Mite Dimitrijoski, Arben Ristemi – përfaqësues nga administrata komunale, Drejtori i SHMK „Mirko Mileski“, Drejtori i IK Universiteti i Punëtorëve „Krste Misirkov“, Drejtori i SHFK „Sande Shterjoski“, Drejtori i SHFK „Gj.K.Skënderbeu“ fsh. Sërbicë, Sekretari i IPK ÇF „Olga Miceska“ Kërçovë.

Në mbledhje mori pjesë edhe gazetari nga: TV Uskana.

Kryesuesi i këshillit, pasi konstatoi se ka kuorum për punë, pyeti nëse dikush ka vërejtje mbi Procesverbalin e mbledhjes së 5-të të Këshillit të Komunës së Kërçovës, të mbajtur më datë 29.01.2026.

Duke qenë se askush nuk u paraqit për fjalë, Kryesuesi i Këshillit e vendosi në miratim Procesverbalin e seancës së 5-të të Këshillit të mbajtur më datë 29.01.2026

dhe i njëjti u miratua në mënyrë unanime me 18 vota PËR. KUNDËR (nuk ka). T
PËRMBAJTUR (nuk ka).

Kryetari i Këshillit, për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

RENDI I DITËS

1. Propozim Raporti (K1, K2 dhe K3) për realizimin e Buxhetit në Komunën e Kërçovës – kuartali i katërt JANAR-DHJETOR 2025.
2. Propozim Rregullore për ndarjen e vërtetimit-vauçerit për blerjen dhe instalimin e inverter klima me efikasitet të lartë energjetik në anvisëritë për vitin 2026.
3. Propozim Program për Punën e Këshillit të Komunës së Kërçovës për vitin 2026.
4. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për Statutin e SHMK”Gjergj Kastrioti Skenderbeu” fsh.Sërbicë – Kërçovë.
5. Propozim Vendim për emërimin e antarëve në Këshillin Drejtues në SHMK”Mirko Mileski” Kërçovë.
6. Konkluzion për dhënien e mendimit pozitiv për qëndrim të zgjatur të nxënësve në SHFK” Sande Shterijoski” Kërçovë
7. Propozim Vendim për miratimin e Raportit për përlllogaritje të dëmit nga fatkeqësi tjera.
8. Propozim Konkluzion për dhënien e mendimit pozitiv për ndryshimin e Planit për punësim për vitin 2026 në IK UP”Krste Misirkov” Kërçovë.
9. Propozim Marrveshje për pagesë të borxhit me këste ndërmjet NPK”Komunalec” Kërçovë, NP”Studençica” Kërçovë dhe debitori solidar Komuna e Kërçovës.
10. Propozim Plani financiar për vitin 2026 të IPK ÇF”Ollga Miceska” Kërçovë.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi i këshillit pyeti nëse dikush ka ndonjë plotësim ndryshim të Rendit të ditës.

Mihajlo Daniloski - Propozoi plotësim të rendit të ditës, pika e 12-të të jetë: Vendim për pagesën e kotizimit për KF „Napredok“ dhe KF „Vllaznimi“.

Valdet Selimi - Informoi se ka edhe një plotësim tjetër të rendit të ditës, pika e 13-të: Vendim për ndarjen e laptopëve për këshilltarët. Pika e 12-të e propozuar e rendit të ditës tani do të jetë pika e 14-të.

Ilir Rushani - Informoi se në koordinim kanë kërkuar që në rendin e ditës të vendoset pika për rrënimin e ndërtimeve pa leje. Lidhur me këtë, të jetë i pranishëm në seancë edhe Kryetari i Komunës ose dikush nga kabineti i tij për të shpjeguar radhën sipas së cilës rrënohen ndërtimet pa leje. Në rendin e ditës nuk ishte vendosur ajo pikë për këtë seancë, pyeti pse nuk është vendosur në rend dite për këtë mbledhje, pse është hequr nga rendi i ditës dhe pse Kryetari i Komunës nuk është i pranishëm në mbledhje.

Sekretarja e komunës - Informoi se lidhur me atë pikë Kryetari i Komunës ka konsideruar se bëhet fjalë për Raport i cili duhet të përpunohet nga shërbimet dhe ai është në përgatitje e sipër, ndërsa pasi të përpunohet do të vendoset në rend dite. Lidhur me mospjesëmarrjen e Kryetarit të Komunës u përgjigj se kjo ishte për shkaqe objektive.

Ilir Rushani - Pyeti pse dikush nga kabineti i tij nuk ishte autorizuar të marrë pjesë ose dikush nga administrata dhe t'i njoftonte për radhën e rrënimit të objekteve. Theksoi se ai e kërkon këtë tashmë mbledhja e tretë me radhë dhe se nuk kishte transparencë nga ana e Kryetarit të Komunës ndaj tyre dhe qytetarëve. Kërkoj që pikat shtesë të tërhiqen, pasi nuk është respektuar Rregullorja e punës së këshillit, materialet për to janë marrë të premtën dhe nuk ka pasur shtatë ditë deri në mbajtjen e mbledhjes dhe ato pika nuk ishin propozuar në koordinim. Theksoi se nga ana e BL në Kërçovë është dorëzuar kërkesë me nr. 03-847/1 nga data 12.02.2026 dhe kërkesë nga Bashkësia Islame me nr. 03-846/1 nga data 12.02.2026, pyeti pse për to nuk ka materiale dhe pse nuk ka njoftim për to. Pyeti pse ato kërkesa nuk i janë dorëzuar këshillit dhe pse nuk janë në rendin e ditës.

Kryesuesi i këshillit - Informoi se kërkesa nga Bashkësia Islame nuk i është dorëzuar atij dhe pyeti se për çfarë bëhet fjalë.

Ilir Rushani - Informoi se bëhej fjalë për deponinë ilegale.

Kryesuesi i këshillit - Informoi se nuk ka pasur kërkesë të tillë, ndërsa lidhur me deponinë ka pasur demant në rrjetet sociale – faqen e internetit të Komunës, se ato informata nuk ishin të sakta.

Illir Rushani - Informoi se ato informata nuk jepen përmes rrjeteve sociale dhe se Komuna është institucion dhe për këtë duhet të ketë dokument. Kërkoj transparencë dhe pauzë prej 10 minutash për të parë në arkiv nëse kanë arritur kërkesat.

Kryesuesi i këshillit - Informoi se sipas nenit 60 të Rregullores, Rendi i ditës për mbledhjen përcaktohet në fillim të mbledhjes dhe e citoi të njëjtin. Theksoi se nuk kishte bazë që ato pika të tërhiqen.

Illir Rushani - Informoi se edhe ai po flet sipas nenit 59 të Rregullores dhe se nuk kanë marrë materiale për pikat shtesë dhe se nuk ka pasur transparencë.

Kryesuesi i këshillit - Informoi se Kryesuesi i këshillit ka pasur të drejtë ta plotësojë rendin e ditës sipas atij neni.

Illir Rushani - Informoi se është e nevojshme ta kenë materialin.

Valdet Selimi - Informoi se ajo kërkesë nuk kishte arritur deri te këshilli dhe se ai e ka marrë nga arkivi para fillimit të mbledhjes.

Illir Rushani - Informoi se ky ishte problemi i tyre pse nuk kishte arritur deri te këshilli dhe se të dyja kërkesat ishin pranuar nga arkivi dhe pyeti se kush duhet t'i informojë për këtë.

Sekretarja e komunës - Informoi se kërkesat nuk kanë arritur as tek ajo, as te kabineti.

Illir Rushani - Informoi se ato ishin adresuar te Këshilli dhe Kryetari i Komunës, ndërsa pse nuk kanë arritur nuk e di.

Kryesuesi i këshillit dha pauzë prej 10 minutash. Pas pauzës mbledhja vazhdoi.

Sekretarja e komunës - Informoi se kërkesat ishin në kabinet dhe ishin adresuar te Këshilli dhe Kryetari i Komunës. Ato ishin shqyrtuar dhe në bazë të tyre ishte bërë demant për deponinë ilegale në faqen e internetit të Komunës. Pastaj informoi se janë në rrjedhë negociatat për deponinë rajonale dhe se në Kërçovë do të ketë

stacion transferimi për mbeturina i cili do të ndërtohet në bazë të rregullave evropiane dhe se për këtë do të njoftohen me kohë.

Illir Rushani- Kërkoj që të përgatitet njoftim me shkrim për qytetarët dhe t'u përcillet dokument për këtë që edhe ata ta shqyrtojnë. Problemi për këtë ishte në kabinet.

Sekretarja e komunës- Informoi se kërkesat lexohen në pikën Të ndryshme dhe nuk i marrin në materiale, sepse nuk janë dorëzuar në numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve.

Illir Rushani- Informoi se qytetarët duhet të njoftohen me shkrim, që ta dinë se aty nuk do të ndërtohet deponi ilegale.

Syarta Saliju Osmani- Pyeti pse kërkesa e tyre nga AKI injorohet dhe se pika për rrënimin e objekteve ishte aktuale në qytet. Theksoi se Kryetari i Komunës ka përdorur të drejtën diskreciare për ta tërhequr pikën. Informoi se ata nuk do të tërhiqen nga përfaqësimi i 12.000 shqiptarëve në qytet.

Illir Rushani- Informoi se Kryesuesi i këshillit ka kompetencë ta përcaktojë rendin e ditës për mbledhjen dhe i propozoi dhe sugjeroi se nuk duhet patjetër të dëgjohet Kryetari i Komunës për këtë.

Syarta Saliju Osmani- Informoi se Sekretarja arsyetohej për pikën për ndërtimet pa leje se nuk ishte përgatitur nga shërbimet. Theksoi se kjo ishte një bindje e kotë në të cilën ata nuk besonin.

Kryesuesi i këshillit e hodhi në miratim Rendin e ditës me dy plotësimet e propozuara dhe i njëjti u miratua me 14 vota PËR, 4 vota KUNDËR dhe PËRMBAJTUR (nuk ka).

Kalohet në:

1.PIKA E PARË: Propozim Raporti (K1, K2 dhe K3) për realizimin e Buxhetit në Komunën e Kërçovës – kuartali i katërt JANAR-DHJETOR 2025.

Bujar Veseli- Informoi se bëhet fjalë për Raport për kuartal që trajton realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve, borxhin dhe huanë e komunës. Realizimi i buxhetit ishte 73,5% dhe kishte një rritje të vogël. Pastaj, shpjegoi në mënyrë detale. Theksoi se duhet të punohet më shumë në mbledhjen e taksave komunale dhe

tatimit në pronë për një prosperitet financiar më stabil të komunës, ndërsa borxhi i komunës të zvogëlohet.

Stevo Stefanovski- Kërkoj që t'i përgjigjen me shkrim se ndaj kujt ishin obligimet për 30 dhe 60 ditë.

Bujar Veseli- Dha shpjegim lidhur me këtë dhe informoi se do t'i përgjigjet me shkrim në mënyrë më detale.

Kryesuesi i këshillit e vendosi në miratim Propozim Raporti (K1, K2 dhe K3) për realizimin e Buxhetit në Komunën e Kërçovës – kuartali i katërt JANAR-DHJETOR 2025 dhe i njëjti u miratua me 16 vota PËR, KUNDËR (nuk ka) dhe 2 vota PËRMBAJTUR.

2.PIKA E DYTË: Propozim Rregullore për ndarjen e vërtetimit-vauçerit për blerjen dhe instalimin e inverter klima me efikasitet të lartë energjetik në anvisëritë për vitin 2026.

Emilija Petkoska- Informoi se në bazë të pikës 7 të programit për furnizimin e klimave inverter është përgatitur Rregullorja dhe aty ishte përfshirë e gjithë puna për marrjen e vauqerave për klima inverter.

Syarta Saliju Osmani- Informoi se e ka lexuar Rregulloren dhe se në nenin 21 ka pasur fjalë që nuk ishin përkthyer në shqip dhe dha shembuj për këtë. Theksoi se kjo do të ishte hera e fundit që do të kërkonte të përdorej gjuha shqipe.

Emilija Petkoska- Informoi se kjo nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Kryesuesi i këshillit e vendosi në miratim Propozim Rregullore për ndarjen e vërtetimit-vauçerit për blerjen dhe instalimin e inverter klima me efikasitet të lartë energjetik në anvisëritë për vitin 2026 dhe e njëjta u miratua me 18 vota PËR, KUNDËR (nuk ka) dhe PËRMBAJTUR (nuk ka).

3.PIKA E TRETË: Propozim Program për Punën e Këshillit të Komunës së Kërçovës për vitin 2026.

Valdet Selimi- Informoi se Programi është për punën e Këshillit për vitin 2026. Theksoi se ai ishte i ndarë në dy pjesë, edhe atë: e para nga janari deri në qershor dhe e dytë nga korriku deri në dhjetor. Programi ishte i karakterit të hapur dhe mund të ndryshonte.

Kryesuesi i këshillit e vendosi në miratim Propozim Program për Punën e Këshillit të Komunës së Kërçovës për vitin 2026 dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR, KUNDËR (nuk ka), PËRMBAJTUR (nuk ka).

4.PIKA E KATËRT: Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për Statutin e SHMK”Gjergj Kastrioti Skenderbeu” fsh.Sërbicë – Kërçovë.

Drejtoresha- Informoi se Statuti ka pasur ndryshime dhe kërkoi që ato të miratohen ashtu siç janë miratuar nga Bordi i shkollës.

Syarta Saliju Osmani- Dha sugjerim për gjuhën (alfabetin) në nenin 3 të Statutit për kuptueshmëri më të madhe.

Stevo Stefanoski- Pyeti se cili është ndryshimi në Statut.

Drejtoresha- Informoi se është data e patronatit të shkollës, më parë ishte 20 shtatori, ndërsa tani 6 maji – dita e lindjes së Gjergj Kastriotit, si dhe faktin që më parë kanë punuar me dy ndërrime, kurse tani me një, si dhe nevoja të tjera ligjore.

Kryesuesi i këshillit e vendosi në miratim Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për Statutin e SHMK”Gjergj Kastrioti Skenderbeu” fsh.Sërbicë – Kërçovë dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR, KUNDËR (nuk ka), PËRMBAJTUR (nuk ka).

Kryesuesi i këshillit dha pauzë prej 10 minutash që të mbledhet Komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërimë. Pas pauzës mbledhja vazhdoi.

PIKA E PESTË: Propozim Vendim për emërimin e antarëve në Këshillin Drejtues në SHMK”Mirko Mileski” Kërçovë.

Zhaneta Millanovska Petreska- Informoi se komisioni është mbledhur dhe ka diskutuar për pikën dhe ka miratuar propozimet e mëposhtme për anëtarë të bordit: Violeta Stefanoska, Bojan Trajkoski dhe Ajhan Sullkoski. Propozoi që propozimi të miratohet.

Syarta Saliju Osmani- Informoi se në atë bord më parë ka pasur përfaqësues nga Sektori i arsimit, ndërsa tani nuk ka. Theksoi se do të ishte më mirë të kishte edhe përfaqësues nga administrata komunale për koordinim më të mirë.

Drejtori i SHMK „Mirko Mileski“- Informoi se nuk bëhej fjalë për Bord Drejtues, por për Bord të Shkollës dhe kjo duhet të përmirësohet në Vendim. Bordi

numëronte 12 anëtarë dhe tre prej tyre ishin që i delegonte komuna. Mandati i tre anëtarëve të mëparshëm kishte skaduar dhe tani duheshin zgjedhur të rinjtë.

Kryesuesi i këshillit e vendsosi në miratim Propozim Vendim për emërimin e antarëve në Këshillin Drejtues në SHMK "Mirko Mileski" Kërçovë dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR, KUNDËR (nuk ka), PËRMBAJTUR (nuk ka).

6. PIKA E GJASHTË: Konkluzion për dhënien e mendimit pozitiv për qëndrim të zgjatur të nxënësve në SHFK "Sande Shterijoski" Kërçovë

Drejtori- Informoi se hapësira për qëndrim të zgjatur ditor të nxënësve është rregulluar, në të do të punojnë mësues që tashmë ishin të punësuar në shkollë. Kërkoj që Vendimi të miratohet nga ana e Këshillit.

Ilir Rushani- Informoi se në paragrafin 2 thuhej se mjetet financiare do të siguroheshin nga komuna dhe shkolla. Pyeti nëse janë siguruar ato mjete.

Drejtori- Informoi se mjetet janë siguruar dhe punonjësit për atje ishin nga shkolla dhe nuk kishte nevojë për plotësim.

Ilir Rushani- Informoi për atë që pyeti, sepse, nëse është e nevojshme, ata të sjellin Vendim të veçantë në Këshill që të mund të funksionojë qëndrimi i zgjatur.

Teuta Ahmedi Purellku- E përshëndeti iniciativën për qëndrimin dhe informoi se kjo është e nevojshme për të gjithë. Me këtë investohej në arsimimin e fëmijëve, pasi ata atje do të mësojnë, do të socializohen etj.

Drejtori- Falënderoi.

Stevo Stefanoski- E përshëndeti iniciativën dhe pyeti pse materialet për atë pikë dhe për pikën e dhjetë nuk ishin përkthyer në maqedonisht dhe apeloj që kjo të mos përsëritet.

Ilir Rushani- Informoi se materialet janë dygjuhëshe dhe se në mbledhjen e mbajtur më 30.12.2025 e kanë pasur atë pikë dhe kishte kërkuar të tërhiqet nga rendi i ditës sepse nuk ishin përkthyer në shqip. Tani materialet ishin vetëm në shqip, e jo në maqedonisht, pasi në maqedonisht i kanë pasur që atëherë.

Stevo Stefanoski- Informoi se nuk ka qenë i pranishëm në atë mbledhje.

Kryesuesi i këshillit e vendosi në miratim Konkluzion për dhënien e mendimit pozitiv për qëndrim të zgjatur të nxënësve në SHFK” Sande Shterijoski” Kërçovë dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR, KUNDËR (nuk ka), PËRMBAJTUR (nuk ka).

PIKA E SHTATË: Propozim Vendim për miratimin e Raportit për përllogaritje të dëmit nga fatkeqësi tjera.

Igor Pejосki – Informon se Raporti ka të bëjë me vërshimet nga Lumi i Zajazit dhe Treska, të cilat ndodhën më 6 dhe 7 janar të këtij viti. Ishin përmbytur një numër i madh i amvisërive dhe janë dorëzuar 221 kërkesa nga persona fizikë dhe 7 nga subjekte juridike. Kërkesat janë shqyrtuar dhe dëmet janë evidentuar me procesverbal për çdo amvisëri veç e veç. Shuma e përgjithshme ishte rreth 30 milionë denarë ose 470 mijë euro. Ky raport, pasi të miratohet, i dërgohet Qeverisë dhe ata marrin Vendim për lartësinë e pagesës së dëmit. Ato mjete transferohen në një llogari të veçantë të komunës, e më pas u shpërndahen atyre të cilët janë të dëmtuar.

Shefki Imeti – Informon se dëmet ishin të mëdha, ndërsa vlerësimi ishte i ulët. Pyeti se qfarë masash ka ndërmarrë komuna për të parandaluar vërshime të reja. Dje pati vërshime të reja, sa do të ishte shuma me vërshimet e reja? Pyeti nëse po ndërmerren masa.

Igor Pejосki – Informon se ai raporton në cilësinë e kryetarit të komisionit për dëme. Theksoi se është bërë revitalizimi i shtratit të lumit.

Illir Rushani – Informon seatëherë për këtë ato duhet të informohen nga kabineti i Kryetarit të Komunës. Në sallën e sportit ishin vendosur 200 njerëz pa kushte bazë. Informon se ka banesa të tilla për ta dhe pyeti pse njerëzit nuk janë trajtuar siç duhet.

Sekretari i komunës – Informon se gjatë një muaji kanë ndodhur dy vërshime. Theksoi se njerëzve të vendosur në sallën e sportit u është siguruar ushqim, ujë, kontrolle mjekësore etj. Ndihtë ka pasur edhe nga Ndërmarrja Publike „Komunalec“, nga Njësia Teritoriale Kundër Zjarrit (NJTKZ) Kërçovë, si dhe nga qytete të tjera.

Illir Rushani – Pyeti mbi bazën e cilave kriteresh është vlerësuar dëmi, pasi vlera e përcaktuar ishte e vogël. Qeveria mund t'i dëmshpërblejë nga 10-30%. Pyeti se si është përcaktuar Metodologjia e llogaritjes.

Igor Pejосki – Informon se kjo konstatohet me dalje në vendngjarje. Komisioni ka punuar në bazë të Metodologjisë dhe çdo gjë është kryer në mënyrë reale. Çdo mjet material që është dëmtuar vlerësohet me 60% dëmtim.

Teuta Ahmedi Purlku – Informon se te ne problemi me vërshimet është serioz. Një numër i madh i qytetarëve ishin përmytur. Seriozisht duhej të pastroheshin kanalizimet dhe ujërat kulluese, që kjo të mos përsëritet më.

Më pas, Kryetari i këshillit e hodhi në votim Propozim Vendim për miratimin e Raportit për përlllogaritje të dëmit nga fatkeqësi tjera dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

PIKA E TETË: Propozim Konkluzion për dhënien e mendimit pozitiv për ndryshimin e Planit për punësim për vitin 2026 në IK UP”Krstе Misirkov” Kërçovë.

Drejtori – Informon se ishte e nevojshme të ndryshohej një vend pune i cili duhej të sistematizohej. Kjo ishte e paraparë në pjesën 4.

Illir Rushani – Pyeti nëse është marrë pëlqimi nga Ministria që të mund të realizohet punësimi.

Drejtori – Informon se Ministria e Kulturës jep pëlqim për rrogat. Së pari duhej të miratohej në këshill, e më pas vijon vendimi nga Ministria e Kulturës, e cila kërkon pëlqim nga Ministria e Financave. Nëse sigurohen mjetet, do të zhvillohet procedurë e re për shpalljen e konkursit për punësim.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Konkluzion për dhënien e mendimit pozitiv për ndryshimin e Planit për punësim për vitin 2026 në IK UP”Krstе Misirkov” Kërçovë dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

PIKA E NËNTË: Propozim Plani financiar për vitin 2026 të IPK ÇF”Ollga Miceska” Kërçovë

Sekretari i kopshtit – Informon se ajo është këtu sot, pasi Drejtoresha ishte e zënë me vërshimet dhe nuk mund të vinte. Theksoi se plani u ishte dorëzuar në formë elektronike.

Illir Rushani – Përgëzoi për përdorimin e gjuhës shqipe në materialet e dorëzuara dhe informoi se do ta mbështesin këtë edhe në të ardhmen.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Propozim Plani financiar për vitin 2026 të IPK ÇF"Ollga Miceska" Kërçovë dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

PIKA E DHJETË: Vendim për fillimin e procedurës për realizimin e konkursit për përzgjedhjen e zgjidhjes ideore arkitektonike për rikonstruim, zgjerimin dhe dizajn urban të sheshit ekzistues në Kërçovë

Riste Lazarevski - Informon se nga ana e Kryetarit të Komunës, Sektori i urbanizmit ka marrë detyrë për rregullimin e sheshit të qytetit. Sheshi duhet të zgjerohet dhe të ketë vlerë të re. Theksoi se koncepti ishte në dy pjesë dhe kishte një shfaqje grafike se deri ku mund të zgjerohet ai. Për të realizuar këtë, ishte e nevojshme të ftoheshin më shumë byro projektuese përmes një shpalljeje publike. Më pas, komuna do të shpërblente tre punime, të cilat do të bashkoheshin dhe do të punonin sëbashku. Informon se pritet një kapacitet i ri hapësinor dhe do të ketë ndryshim të regjimit të komunikacionit, si dhe një regjim special për automjete të caktuara gjatë ditës, duke dhënë sqarime shtesë. Theksoi se për këtë janë bërë analiza.

Shefki Imeti - Informon se në vitet e fundit sheshi është rikonstruktuar dhe ata ishin kundër kësaj. Theksoi se nuk kishte nevojë për këtë, pasi tani kishte probleme me vërshimet dhe deponinë.

Riste Lazarevski - Informon se kjo është pjesa ideore dhe kjo do të ishte mirë për qendrën e qytetit.

Ilir Rushani - Informon se për këtë nuk ka pasur diskutim publik, duhej të ishte transparente dhe nuk duhej të zbatohet pa mendimin e qytetarëve. Kërkoj që pika të tërhiqet për seancën e ardhshme.

Riste Lazarevski - Informon se kjo është zgjidhje ideore dhe tani kërkohet vetëm të fillohet me punë, ndërsa më pas do të shihej se çfarë do të pranohej e çfarë jo. Theksoi se më pas do të kishte studime, xhirime, zgjidhjet më të mira ideore etj. Ky ishte fillimi i një ideje.

Shefki Imeti - Informon se në seancën e kaluar kanë votuar për ndryshimin e Planit Gjeneral Urbanistik (PGJU) dhe duhej parë se ku do të pozicionohej sheshi në të.

Riste Lazarevski - Informon se tani flitej vetëm për zgjidhje ideore dhe nëse ajo do të pranohej, pavarësisht PGJU-së.

Suarta Saliu Osmani - Informon se realisht kjo pikë e ka habitur. Ajo nuk ishte prioritet, kishte probleme të tjera tani sipas të cilave duhej vepruar. Më pas përmendi disa shembuj, si ai me qentë endacakë për të cilët nuk është punuar. Theksoi se kjo nuk është e nevojshme dhe nuk e mbështet.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Vendim për fillimin e procedurës për realizimin e konkursit për përzgjedhjen e zgjidhjes ideore arkitektonike për rikonstruim, zgjerimin dhe dizajn urban të sheshit ekzistues në Kërçovë dhe i njëjti u miratua me 12 vota PËR, 4 vota KUNDËR dhe 2 vota PËRMBAJTUR.

PIKA E NJËMBËDHJETË: Vendim për themelimin e Ndërmarrjes Publike për planifikim, zgjerim dhe mbikëqyrje

Dragan Dejanoski - Informon se sot është mbledhur në përbërje të plotë Komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe objekteve të tjera infrastrukturore dhe ka vendosur me 4 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe asnjë PËRMBAJTUR, që emri i ndërmarrjes të jetë „Kërçova Projekt,,.

Sekretari i komunës - Informon se Vendimi ishte për formimin e një Ndërmarrjeje Publike e cila do të kryejë gjithçka që është e nevojshme për qytetin në lidhje me planifikimin, zgjerimin dhe mbikëqyrjen, dhe kjo do të ishte më e favorshme financiarisht për komunën.

Ilir Rushani - Informon se nuk është e nevojshme të formohet një subjekt i ri, por sipas nevojës të angazhohen ndërmarrje të licencuara për atë qëllim. Theksoi se kjo do të ishte një kosto shtesë për komunën e cila nuk është e nevojshme, ose këtë mund ta bënte një Sektor i veçantë. Informon se kjo nuk do të jetë e qëndrueshme financiarisht. Theksoi se emri i NP Kërçova Projekt nuk e përfaqësonte identitetin tonë dhe duhej të përfaqësonte identitetin e të gjithëve. Informon se janë kundër.

Sekretari i komunës - Informon se veprimtaria e ndërmarrjes ishte e tillë që komuna nuk mund ta kryente vetë dhe për këtë kishte një kod të veçantë veprimtarie. Është bërë konstruksioni financiar dhe është parë se është më e favorshme për komunën, në krahasim me angazhimin e ndërmarrjeve private. Prioritet në të gjithmonë do të kishin projektet e komunës.

Shefki Imeti - Informon se në komision ka qenë kundër në lidhje me emrin. Informon se jemi vend i vogël dhe se nuk kishte nevojë për këtë. Me këtë po krijohet monopol dhe barrë për komunën. Theksoi se nuk do të ishte funksionale dhe se kështu ishte edhe me Studençicën.

Ilir Rushani - Informon se kodin e veprimtarisë komuna mund ta ndryshonte. Ajo ndërmarrje do të financohej nga komuna e jo nga niveli qendror, prandaj ishte më mirë të kishte një Sektor për këtë. Kërkoj që për këtë të mos votohet tani dhe të shqyrtohet më mirë në seancën e ardhshme. Propozoi që të tërhiqet, pasi do të financohet nga buxheti i komunës.

Syarta Saliju Osmani – Informon se ata janë kundër kësaj NP, dhe renditi 5 arsye për këtë: 1. Themelimi i NP-së do të jetë një ngarkesë shtesë për buxhetin e komunës me kosto shtesë për paga, shpenzime operative, etj. 2. Mungesa e arsytimit ekonomik dhe arsyei për këtë 3. Ekzistenca e subjekteve aktuale që e bëjnë këtë punë dhe kanë licencë. 4. Rreziku i politizimit gjatë punësimit dhe menaxhimit, gjë që mund të çojë në efekte negative në punë. Dhe 5. Mungesa e një studimi fizibiliteti – nuk ka mjaftueshëm analiza financiare për cilësinë e ndërmarrjes. Ajo theksoi se themelimi i NP-je nuk është në interes të komunës.

Riste Lazarevski – Informon se kjo ndërmarrje nuk mund të ishte brenda komunës, por duhet të jetë jashtë saj. Theksoi se për më shumë se 10 vjet, planet urbanistike janë sjellë nga ndërmarrje të tjera, ndërsa tani kjo do të ndryshojë dhe do të bëhet në interes të qytetarëve.

Ilir Rushani – Pyeti se kush do të jetë themeluesi i ndërmarrjes dhe kush do ta emërojë Drejtorin dhe Bordin Drejtues.

Riste Lazarevski – Theksoi se ndërmarrja nuk mund të jetë në Sektorin e Urbanizmit, sepse në atë rast do të ndodhte që vetë të urdhërojnë e vetë të miratojnë.

Sekretari i Komunës – Informon se pas formimit të NP-së, do të miratohet Statuti i ndërmarrjes dhe do të ketë punësime minimale. NP-ja do të formojë këshill dhe ai do të ketë mekanizma të tjerë kontrolli mbi punën e saj në raport me komunën.

Ilir Rushani – Pyeti nëse është hulumtuar diçka në lidhje me ndërmarrje të tilla publike.

Riste Lazarevski – Informon se janë bërë analiza se si punojnë ndërmarrje të tilla në Prilep, Kumanovë, Manastir etj., dhe është parë se ato punojnë mjaft pozitivisht. Më pas, ai dha shpjegime me shembuj. Informoi se nuk do të kishte dëm nga formimi i ndërmarrjes dhe theksoi se për formimin e NP-së nevojitej punësimi i 5 personave.

Syarta Saliju Osmani – Pyeti, nëse është në interes të qytetarëve a do të miratohet PGJU dhe nëse nuk miratohet brenda 1 viti, do të konsiderohet se kjo po formohet vetëm për punësime të reja.

Riste Lazarevski – Informon se PGJU-u do të kushtojë 400.000 denarë dhe theksoi se kjo NP do të jetë në dobi të komunës.

Stevo Stefanoski – Informon se sipas Rregullores së Punës, duhet të mbahet rend gjatë diskutimeve.

Shefki Imeti – Informon se është e nevojshme që këtu të flitet në mënyrë transparente në interes të qytetarëve.

Syarta Saliju Osmani – Informon se për PGJU nevojitet një shumë më e madhe parash, por nuk ishte vetëm kjo, por bëhej fjalë edhe për punësime partiake.

Stevo Stefanoski – Informon se kjo është një temë serioze dhe sigurisht që është bërë dhe ka një lloj miratimi financiar. Formimi do të miratojë edhe dinamikën e hartimit të PDU-së dhe planeve të tjera parciale që janë paraparë në Programin për tokë ndërtimore. Theksoi se nëse në ndërmarrje punojnë 5-10 persona, ata me punën e tyre do t'i arrijnë mjetet financiare. Informoi se punësimet nuk mund të jenë politike dhe se ata duhet të jenë persona me licenca të autorizuar dhe profesional, e jo nga komuna. Theksoi se ndërmarrja do të funksionojë për një periudhë të gjatë dhe do të jetë përfitim për të gjithë.

Riste Lazarevski – Informon se vetë ndërmarrja do ta rregullojë dinamikën e punës.

Stevo Stefanoski – Informon se komuna do të kërkojë nga NP-ja si kërkues se cila do të jetë dinamika.

Riste Lazarevski – Theksoi se komuna do të kërkojë nga ndërmarrja hartimin e projekteve sipas prioriteteve. Qëllimi ishte të bëheshin një numër më i madh projektesh.

Syarta Saliju Osmani – Informon se për punësimet partiake është motivuar nga shfuqizimi i Kontratave të punës të punonjësve në komunë dhe se vetëm një pjesë e tyre ishin vazhduar.

Ilir Rushani – Kërkoj që të mos diskriminohet askush dhe dëshironte të shihte se si votonin edhe të tjerët për këtë.

Kryetari i Këshillit e vendosi në miratim Vendim për themelimin e Ndërmarrjes Publike për planifikim, zgjerim dhe mbikëqyrje i cili u miratua me 12 vota PËR, 5 vota KUNDËR dhe 1 votë PËRMBAJTUR.

PIKA E DYMBËDHJETË: Vendim për pagesën e kotizimit për KF „Napredok,, dhe KF „Vllazërimi,,

Valdet Selimi informon se të dy klubet futbolistike, Napredok dhe Vllazrimi, kanë dorëzuar kërkesë për pagesën e kotizimit në vlerë prej 80.000 denarë për klub për gjysmësezonin. Propozoi që kjo kërkesë të mbështetet.

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Vendimin për pagesën e kotizimit për KF „Napredok,, dhe KF „Vllazërimi,, dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

PIKA E TREMBËDHJETË: Vendim për ndarjen e laptopëve për këshilltarët

Kryetari i këshillit e vendosi në miratim Vendimin për ndarjen e laptopëve për këshilltarët dhe i njëjti u miratua me 18 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

PIKA E KATËRMBËDHJETË: Të ndryshme

Ilir Rushani - lidhur me kërkesën e dorëzuar për problemin me ndërtimin e deponisë në vendin e quajtur Trebiquevë, kërkoi që në interes të qytetarëve t'u dërgohet një përgjigje dokument me shkrim, i nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Këshillit.

Sekretari i Komunës informon se atje nuk mund të ndërtohet deponi e egër. Komuna është në bisedime për ndërtimin e një deponie rajonale, selia e së cilës duhet të përcaktohet nga këshilli në përputhje me ligjin. Theksoi se në këtë moment në vendin e përmendur nuk ka deponi.

Stevo Stefanoski si kryetar i komisionit për urbanizëm, informon se në koordinim janë marrë vesh që të thirret një mbledhje e komisionit në përbërje më të gjerë, me qëllim që të shqyrtohen të gjitha kërkesat për ndërtime dhe higjienën komunale që janë në kompetencën e tyre. Gjithashtu, të ftohen edhe shërbimet kompetente që edhe ata të veprojnë sipas detyrës. Theksoi se ajo mbledhje të thirret si seancë plotësuese, ndërsa tani anulohet për shkak të vërshimeve të djeshme.

Mihajlo Daniloski informon se lidhur me vërshimet duhet të ketë mbështetje publike dhe unitet të komunës në koordinim me Ndërmarrjen Komunale Komunalec, Njësinë Teritoriale Kundër Zjarrit në Kërçovë dhe komunat e tjera që ndihmuan, si dhe mbështetje për Kryetarin e Komunës. Theksoi se nëse është e nevojshme për këtë, ata si Këshill mund të thirrnin seancë të jashtëzakonshme.

Kryetari i këshillit e lexoi kërkesën me nr. 08-727/1 të datës 06.02.2026 nga banorët e lagjes Ivanidoll në rrugën Trenko Taseski për rregullimin e kanalit dhe ndërtimin e një ure në atë pjesë për shkak të daljes së kanalit nga shtrati dhe vërshimit të shtëpive. Kërkesën e dorëzojnë për herë të dytë, pasi përbërja e kaluar e komunës nuk u kishte dalë në ndihmë.

Këshilli vendosi që kërkesa t'i përcillet Sektorit për veprimtari komunale.

Pastaj, Kryetari i këshillit lexoi edhe kërkesën me nr. 08-793/1 të datës 10.02.2026 nga Shoqata e taksistëve EDINSTVENI Kërçovë për gjetjen e një zgjidhjeje për problemet me të cilat ballafaqohen transportuesit e licencuar me auto-taksi. Disa nga problemet janë: tarifa e çmimit për kilometër, nisja (starti) për tarifën ditore dhe nate me propozimet e tyre, rritja e numrit të vendparkimeve për taksitë nëpër qytet dhe shënimi i tyre me ngjyrë, ndjekja e taksistëve ilegalë, subvencionet për automjete hibride dhe miratimi i automjeteve me lizing, si dhe të merret vendim që taksitë të mos jenë me ngjyrë të verdhë.

Valdet Selimi informon se kërkesa duhet t'i dërgohet kabinetit të Kryetarit të Komunës për shqyrtim.

Illir Rushani – e mbështeti Mihajlon dhe informoi se Kryetari i Komunës nuk i ka respektuar dhe nuk ka ardhur të kërkojë diçka prej tyre, por nëse ka pasur nevojë për diçka, ata kanë qenë gjithmonë aty.

Stevo Stefanoski pyeti nëse në komunë ka të punësuar inxhinier të komunikacionit ose inspektor që duhet të rregullojë dhe kontrollojë taksistët.

Sekretari i Komunës informon se komuna ka të punësuar inspektor të autorizuar për komunikacion dhe se janë lëshuar licenca për transport taksi. Ai është kompetent për një pjesë të atyre kërkesave, ndërsa pjesa tjetër është në kompetencë të shërbimeve të tjera.

Valdet Selimi informon se në kërkesë janë cekur shumë probleme dhe ajo i është dorëzuar edhe Kryetarit të Komunës. Prandaj, u vendos që t'i drejtohet Kryetarit të

Komunës dhe ta shqyrtojnë bashkë me inspektorin e komunikacionit dhe, nëse është e nevojshme, të formohet një komision për ta shqyrtuar këtë çështje.

Përshkak se askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe me këtë u shterë rendi i ditës për këtë seancë, ndërsa Kryetari i këshillit e mbylli seancën në ora 13 e 15.

Procesverbalist

-Lenqe Srbinoska

Përkthyes:Tefik Asani

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Ajhan Sulkovski